


# Programi i Punës (Korrik 2011 ~ Dhjetor 2012)



Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA)  
Qeveria e Shqipërisë, përfaqësuar nga Bashkia e Tiranës

## Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës



### Organizimi i Studimit



- ▶ **S/C Chairperson:**
  - ▶ Deputy Mayor, MOT
- ▶ **S/C Members:**
  - ▶ Advisors to Territorial Planning;
  - ▶ General Directorate of Territorial Planning and Development, MOT;
  - ▶ General Directorate of Strategic Projects and Foreign Investment, MOT;
  - ▶ General Directorate of Planning and Management of Services, MOT;
  - ▶ Water Regulatory Authority of Albania, GOA;
  - ▶ National Territorial Planning Agency, GOA;
  - ▶ Ministry of Environment, Forests and Waters Administration, GOA;
  - ▶ Ministry of Public Works and Transport, GOA;
  - ▶ Experts from Civil Society; and
  - ▶ JICA Balkan Office.

### Përmbledhja e Projektit

**Ekipi Studimor i JICA-s, me përbërje nga:**

Value Planning International, Inc.  
NJS Consultants, Co., Ltd.,

# 1 HYRJE

Qeveria e Shqipërisë i kërkoi Qeverisë së Japonisë ndihmë teknike për kryerjen e studimit, të quajtur “Projekti për Planin Tematik Urban të Tiranës.” Studimi pritet të hartojë projekte dhe programe afatshkurtra dhe afatmesme për infrastrukturën urbane në bazë dhe në përputhje me Planin e Ri Rregullues të Bashkisë së Tiranës. Bazuar në këtë kërkesë, Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (JICA), organizmi zyrtar për zbatimin e asistencës së Japonisë për zhvillim, në nëntor dhe dhjetor 2010 dërgoi një mision përgatitor, për të kryer një studim paraprak në Tiranë në përgatitjen e objektit të punës të studimit. Më 9 dhjetor 2010, të dyja palët nënshkruan Objektin e Punës së studimit, e cila ishte baza e JICA për të zgjedhur një konsorcium për kryerjen e studimit. Konsorciumi, i quajtur “Ekipi Studimor i JICA-s” i kryesuar nga Dr. Katsuhide NAGAYAMA, përbëhet nga Value Planning International, Inc. dhe NJS Consultants Co. Ltd., selitë qendrore të cilave janë të vendosura në Tokio, Japoni.

## 2 PËRMBLEDHJE MBI SHQIPËRINË

### Territori Kombëtar

28 748 Km<sup>2</sup>

### Popullsia

Mendohej se popullsia në Shqipëri që nga janari 2011 ishte rreth 3,2 milionë banorë; 1,6 milionë meshkuj dhe 1,6 milionë femra dhe në krahasim me të dhënat e 2001, popullsia kishte një rritje të qëndrueshme nga 3,06 milionë në vitin 2001 me një rritje prej rreth 140 000 banorësh në 10 vjet. Por, CENSUS i Popullsisë dhe Banesave në 2011 zbuloi se popullsia e Shqipërisë tani është 2 830 000 banorë, që do të thotë një rënie prej 230 000 banorësh gjatë dhjetë viteve të fundit.

## Industria

Industritë e mëdha në PBB janë Agrikultura, Industria Përpunuese, Ndërtimi dhe Komunikimi. Ndërmjet tyre, Tregtia dhe Shërbimet llogariten rreth 51.0% e totalit të PBB në 2011

## Politika

Shqipëria është një demokraci parlamentare me një ekonomi në tranzicion. Reformat e tregut të lirë kanë hapur vendin për investimet e huaja, sidomos në zhvillimin e energjisë dhe infrastrukturës së transportit


## 3 PËRMBLEDHJE E STUDIMIT

### Objektivat

1. Të zhvillojë plane tematike urbane mbështetur në Planin Rregullues dhe planet e tyre të zbatimit të cilat do të hartohen,
2. Të transferojë aftësitë përkatëse tek personeli i homologëve shqiptarë gjatë rrjedhës së studimit

### Zona e Studimit

Studimi do të mbulojë gjithë Zonën Metropolitane të Tiranës (ZMT), përcaktuar nga Plani i Ri Rregullues, që përfshin zonën e urbanizuar dhe atë që do të urbanizohet me një sipërfaqe rreth 88 km<sup>2</sup>, ku përfshihen Bashkia e Tiranës dhe shtatë (7) bashki dhe komuna të tjera, si: Bashkia e Kamzës dhe Komunitat Dajt, Farkë, Kashar, Paskuqan, Vaqarr dhe Bërxullë. Këto komuna kufitare janë përfshirë pjesërisht në ZMT, në varësi të përparimit të urbanizimit.



## Nënsëktorët Kryesor të Infrastrukturës

1. Rrugët dhe Transporti Urban
2. Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta
3. Sistemi i Furnizimit me Ujë
4. Sistemi i Kanalizimeve/Kullimit


## Rezultatet e Pritshme

1. Plane tematike për zhvillimin e infrastrukturës urbane në perspektivën afatshkurtër (5 vjet) dhe afatmesme (10 vjet);
2. Plane veprimi afatshkurtër për zbatimin e projekteve parësore.

## Organizmat Homolog

Bashkia e Tiranës

## Procesi i Planifikimit



## 4 PËRMBLEDHJE E REZULTATEVE TË STUDIMIT

### Rrugët dhe Transporti Urban

U hartuan tre projekte parësore në sektorin e rrugëve dhe transportit urban, përkatësisht, 1) Unaza e Jashtme (Segmenti i Veriut), 2) Zhvillimi i Akseve që Mungojnë në Unazën e Brendshme/Mesme, dhe 3) Projektet e Transportit Publik të Integruar dhe Zhvillimit të Vendparkimeve. Çdo projekt parësor përfshin disa prej nënprojekteve, të cilët janë të gjithë të ndërlidhur.

### Menaxhimi i Mbetjeve të Ngurta

Projektet parësore u zgjidhën ndërmjet planeve, programeve dhe projekteve të formuluar në Planin e MIMN mbështetur në kriteret e nevojës, nivelit dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis. 10 projekte parësore u përzgjidhën për Planin e MIMN të Bashkisë së Tiranës,

përkatësisht, 1) Projekti i Pastrimit të Venddepozitimeve të Paligjshme, 2) Ndarja e Shërbimit të Grumbullimit të Mbetjeve dhe Shërbimit të Transportit, 3) Futja e Programeve të 3R, 4) Projekti i Trajtimit të Mbetjeve Organike, 5) Projekti i Mbetjeve për Energji, 6) Projekti i Zgjerimit të Objekteve të Depozitimit të Mbetjeve, 7) Forcimi Organizativ, 8) Forcimi i Monitorimit dhe Vlerësimit, 9) Forcimi Financiar, dhe 10) Programe për Rritjen e Ndërgjegjes së Publikut.

## Sistemi i Furnizimit me Ujë

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm të furnizimit me ujë është çështje e domosdoshme dhe e menjëhershme për zhvillimin e qëndrueshëm të Bashkisë së Tiranës. Ujësja duhet të sigurojë ujë të pastër dhe pa ndërprerje për 24 orë. Pesë projekte parësore janë përzgjedhur, përkatësisht, 1) Zgjerimi i ITU të Bovillës dhe shtrimi i linjës shtesë të ujit të patrajtuar për të shfrytëzuar ujin, që del nga shtrati i digës Bovillës, 2) Plani i kursimit të energjisë për të ulur koston e saj, që përbën një të katërtën e koston të përgjithshme të F&M të UKT, 3) Plani i pakësimit të Ujit pa të Ardhura, 4) Prezantimi i sistemit të hartës së tubacionit për të ndihmuar punën e F&M për rrjetin e shpërndarjes së ujit, dhe 5) Zhvillimi i kapaciteteve për forcimin e organizimit të UKT.

## Sistemi i Kanalizimeve/Kullimit

Faza II e projektit të Rajonit të Kanalizimeve Kashar është përzgjedhur si një projekt me përparësi të madhe, pas suksesit të pritshëm në zbatimin e Fazës I të Projektit. Kërkohej reforma organizative dhe për zhvillimin e burimeve njerëzore të UKT për funksionim dhe menaxhim sa më të mirë të sistemit të trajtimit.

## 5 HAPI TJETËR

Ky studim përfshin drejtimet bazë të zhvillimit të sektorëve kryesor të infrastrukturës dhe veprimet parësore, që duhen ndërmarrë për sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme dhe të baraspeshuar të Zonës

Metropolitane të Tiranës duke synuar vitin 2027, bazuar në një perspektivë afatgjatë, ose deri pas dy dhjetëvjeçarësh.

Është hartuar një Plan Tematik, ku përfshihen: Plani i Përdorimit të Tokës; Plani i Zhvillimit të Rrugëve dhe Transportit; Plani i Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta; Plani i Zhvillimit të Sistemit të Furnizimit me Ujë dhe Plani i Zhvillimit të Sistemeve të Kullimit dhe Kanalizimeve. Megjithatë, plani, si tërësi, është ende subjekt i koordinimit të mëtejshëm me Planin e ri Rregullues, që tani është duke përfunduar nga Bashkia e Tiranës me procesin e dëgjësive me qytetarët. Të gjitha propozimet dhe rekomandimet në këtë raport duhet të qartësohen e shqyrtohen për t'u ndërthurur me planin rregullues përfundimtar, nëse është i nevojshëm.

Trupi zbatues apo autoriteti përgjegjës është i lutur ta shohë me kujdes profilin e projektit në mënyrë që ato të bëhen udhërrëfyese të mira dhe të frytshme për zbatimin e projektit.

Paralelisht me punën e planifikimit, u krye një Vlerësim Strategjik Mjedisor në përputhje me Ligjin e ri të Planifikimit të Territorit. Megjithatë, duhet të ketë një qasje më të madhe drejt pjesëmarrjes për të përpunuar projektin e planifikuar nga palët e interesuara përpara zbatimit të tij.

